

Ndërmarrja Publike Lokale
"Stacioni i Autobusave" SH.A.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

Nr. 452/21 Dt. 26.10.2021
SUHAREKË



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE"
SH.A. SUHAREKË

Në mbështetje të nenit 8, të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ NR.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 2 dhe 3 të Rregullores për Marrëdhënie Pune, nenit 14 paragrafi 7 të Rregullores për organizimin e brendshëm të Npl-së dhe caktimin e titujve, detyrave dhe kompetencat e secilit zyrtarë të npl-së, autorizimin e Bordit të Drejtorëve të datës: 25.10.2021, Kryeshefi Ekzekutiv i NPL "Stacioni i autobusave" SH.A në Suharekë.

Shpall:

KONKURS

Titulli i Pozitës:

1. Arkatar/e.

Kohëzgjatja e Kontratës:

1. Për kohë të pacaktuar me orar të plotë.

Puna Provuere:

1. Zgjatë 3 (tre) muaj.

Përvoja e punës:

- Përgaditja e mesme (diplomë e shkollimit të mesëm);
- 2(dy) vite përvojë pune;
- Shkathtësi në punë;
- Njohja e punës me programe kompjuterike.

Detyrat dhe përgjegjësit:

Detyrat kryesore;

- 1) Hapja e librave të arkës;
- 2) Në të gjitha librat bëhen hyrje-daljet e pagesave të ndryshme nëpër bankë;
- 3) Pranon mjetet e gatshme nga inkasantët;
- 4) Pranon regjistrat e pagesave, të njejtat nënshkruhen nga inkasantët;
- 5) Kryen punë dhe detyra tjera të përcaktuar nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Kandidatët për pozitat e punës Arkatar/e në Ndërmarrjen Publike duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- CV-në.
- Letër motivimin.
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës).
- Certifikatën (dëshminë) që dëshmon se nuk është nën hetime.
- Shtetas i R.Kosovës (kopje të letërnjoftimit).

Aplikacionet mund të merrën në NPL "Stacioni i Autobusave" sh.a. nga ora 9:00 deri 12:00 për qdo ditë pune.

Dokumentacioni duhet të jetë në pliko (zarf) të mbyllur ku shkruhet emri dhe mbiemri si dhe emri i Ndërmarrjes Publike në të cilën konkurren kandidati dhe të dorëzohen në Zyrën e Kryeshefit Ekzekutiv N.P.L "Stacioni i Autobusëve" sh.a në Suharekë, nga ora 8:00 deri 12:00, nga e Hëna deri të Premtën.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet (Origjinalet mund të kërkohen gjatë intervistës).

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit publik (shtypin ditor).



Kryeshefi Ekzekutiv

/Mr.sc. Halit Elshani/